

## **Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”**

### **Emisioni nr 516 Nehemia 1**

#### **Kapitulli 1**

Tema: Lutja e Nehemias për mbetjen në Jeruzalem.

Njerëzit e zgjedhur të Zotit ishin thirrur për të dëshmuar kundra idhujtarisë, por shumë shpesh ata vetë ishin dorëzuar dhe ishin bërë idhujtarë. Perëndia i dërgoi ata në Babiloni, në burimin e idhujtarisë, për të marrë “kurën e artë.” Ata u kthyen duke hedhur poshtë idhujtarinë. Gjithsesi, restaurimi i tyre nuk ishte i plotë. Ata nuk ishin të lirë që prej kësaj kohe e deri në kohën e perandorisë romake. Testamenti i Ri hapet duke sjellë gjendjen e tyre nën sundimin romak.

Tre njerëz luajtën një rol të rëndësishëm në rindërtimin e Jeruzalemit. I pari ishte Zorobabeli, princi, që përfaqsoi anën politike. Pastaj vinte Ezdra, prifti dhe së fundi Nehemia, njeriu laik. Mbreti, prifti dhe profeti dështuan në rindërtimin e mureve të Jeruzalemit dhe pastrimin e tempullit, kështu që Zoti ngriti Nehemian, të cilin e kemi emërtuar si një njeri laik. Në fakt, sot është e pavend të flasësh për klerin dhe laikun. Njëri është gjysma e tjetrit. Ne kemi nevojë për të dy.

E fillova shërbesën time me një xhaketë, një kollare dhe një kapele. Një nga miqtë e mi më tha se kur qëndroja prapa katedrës me kollaren e bardhë dhe këmishën e bardhë dukeshin si një mushkë që shikonte mbi një gardh të bardhë. Pastaj, një ditë kuptova se nuk isha ndryshe nga njerëzit që ishin ulur në stola. I hoqa ato rroba dhe fillova të vishja rroba që vishnin edhe njerëzit e tjerë.

Një ditë po luaja futboll me disa nga miqtë e mi. Njëri prej tyre ftoi një shok që ishte nëpunës në një kishë. Ai me sa duket nuk e dinte që unë do të vija. Kur ai më pa, më tha: “Oh, Z. McGee qenka këtu. Tani do të na duhet të ruajmë gjuhën.” A e dini se çfarë bëra? Ia ktheva me nxitim: “Dëgjo, vëlla. Unë nuk jam ndryshe nga ty. Nëse do të mallkosh, mallko. Por, le të kuptojmë një gjë: jam apo jo këtu, Perëndia dëgjon gjithçka që ti thua. Kështu, që nuk ka rëndësi nëse unë e dëgjoj apo jo atë çfarë ti thua.” Mendoj që ky është një dallim

i rremë që bëhet sot midis klerizmit dhe laicizmit. Është mjaft e rëndësishme që të dy ata të jenë në miqësi me Zotin. Megjithatë, ishte një laik, ai që rindërtoi muret e Jeruzalemit dhe pastroi tempullin. Besoj se edhe sot Perëndia mund të ngrejë një njeri laik për të bërë një punë të madhe dhe për ta vendosur punën e Tij në një themel të sigurtë. Ne sot kemi nevojë për rindërtim. Në të vërtetë unë po pres që Perëndia të ngrejë një njeri të ri që nuk do të jetë produkt i shkollave tona. Nuk kam asnjë kundërshtim në lidhje me shkollat tona, por herë pas here Perëndia ngre njerëz që nuk e kanë një të kaluar të tillë si Moody, Billi Sunday dhe Billi Graham. Ne kemi nevojë për njerëz si Nehemia. Nehemia besonte në vëzhgimin dhe punën. Ai besonte në punën dhe lutjen. Shiko dhe lutu, ose puno dhe lutu janë fjalët që e karakterizojnë këtë njeri. Ai kishte një punë të mirë në qeverinë e Persisë. Ai ishte kupëmbajtësi i mbretit. Ishte një njeri i mirë, me moral dhe i ndershëm. Ai mund të kishte qëndruar në Persi, por nëse do të kishte qenë kështu nuk do të kishte qenë në rregjistrimin e Zotit. Ne nuk do të kishim dëgjuar asnjëherë për të. Dua të vini re disa gjëra që karakterizojnë këtë njeri ndërkohë që njihemi me të. Më lejoni t'ju prezantoj Nehemian, njeriun laik.

## **SHQETËSIMI I NEHEMIAS PËR MBETJEN NË JERUZALEM**

Shtatë kapitujt e parë të këtij libri trajtojnë rindërtimin e mureve. Pjesa tjetër e librit trajton ringjalljen dhe reformimin. Kapitulli i parë fillon me lutjen e Nehemias.

**“Fjalët e Nehemias, birit të Hakaliahut. Ndodhi që në muajin e Kisleut, në vitin e njëzetë, ndërsa unë ndodhesha në kalanë e Suzës, arriti në Judë Hanani, një nga vëllezërit e mi, bashkë me disa burra të tjerë. Unë i pyeta lidhur me Judejtë që kishin shpëtuar, që ishin kthyer gjallë nga robëria, dhe lidhur me Jeruzalemin.”**  
[Neh.1:1-2].

Kur foli për “judenjtë që kishin shpëtuar”, Nehemia po i referohej atyre judenjve që ishin kthyer në vend. Nehemia mund të ishte kthyer në vend, por për disa arsye nuk e bëri. Ai zuri një vend pune.

Nuk kam ndërmend që ta kritikoj sot, sepse Zoti përdor njerëz të tillë dhe Ai e përdori Nehemian.

Vini re se ky njeri me këtë pozitë të rëndësishme ishte i shqetësuar për punën e Zotit. Ai ishte mjaft i shqetësuar për çështjen e Zotit. Një ditë, ndërsa ishte i zënë duke ecur lart e poshtë në pallat, pa një nga vëllezërit e tij që sapo kishte ardhur nga Jeruzalemi, dhe me shumë mundësi po sillte një mesazh në pallat. Nehemia e ndaloi dhe e pyeti: “Si po shkojnë gjërat në vend?” Dëgjoni se çfarë përgjigje mori:

**“Ata më thanë: "Ata që kanë shpëtuar nga robëria janë atje poshtë në krahinë, në një varfëri të madhe dhe me faqe të zezë; përveç kësaj muret e Jeruzalemit janë plot me të çara dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri". [Neh. 1:3].**

Kjo nuk ishte aspak një pamje e bukur. Në çfarë gjendje të mjerueshme ishte puna e Zotit dhe njerëzit e Tij! Judenjtë ishin diskriminuar, sepse kishin dështuar dhe Zoti nuk do ta kishte lejuar këtë gjë të ndodhte. Fatkeqsisht, ne lejojmë që kjo gjë të ndodhë. Nehemia u shqetësua shumë për këtë raport dhe mund t'i ishte përgjigjur me mënyra të ndryshme. Mund të kishte thënë: “Shumë keq, vëllezër. Më vjen keq që e dëgjoj këtë. Do të lutem për ju. Zoti ju bekoftë.” Ai mund të ishte shprehur në çfarëdo lloj mënyre dhe mund të kishte përdorur klishe të krishtera, por me siguri që nuk i dinte ato. Gjëja e rëndësishme është që Nehemia ishte i shqetësuar.

## LUTJA E NEHEMIAS

**“Sa i dëgjova këto fjalë, u ula dhe qava; pastaj mbajta zi disa ditë me radhë, agjerova dhe u luta përpara Perëndisë të qiellit.” [Neh. 1:4].**

Dua të tërheq vëmendjen tuaj për disa gjëra tek ky varg i vecantë. Nehemia nuk ishte indiferent ndaj gjendjes së vështirë të njerëzve dhe as kritik keqdashës. Ai mund të kishte thënë: “Njerëzit duhet të kishin bërë këtë, ose atë tjetrën.” Nehemia ishte i shqetësuar. Po të kthehemi mbrapa tek libri i Ezdrës, a mbani mend reagimin e tij në lidhje me gjendjen e njerëzve? Ai ishte një prift shumë i shqetësuar

për gjendjen e njerëzve. Por, këtu shohim një njeri laik që është i shqetësuar për këtë gjë.

Sot, kauza e Krishtit është në rrezik. Pyes veten nëse janë kaq të shqetësuar ata që janë kritikë dhe pretendojnë se janë të interesuar për të. Nëse ajo gjë që po kritikoni nuk e thyen zemrën tuaj, atëherë ndaloni më mirë. Sot ka shumë fjalë, por pak lot. Ti nuk je lajmëtari i Zotit nëse mesazhi nuk të shkakton dhimbje personale.

Ndërkohë që mendoj se Ezdra ishte një njeri plak, besoj se Nehemia ishte një djalë i ri. Ezdra me shumë mundësi duhet të ketë qenë një djalë i vogël në kohën e robërimit, por mendoj se Nehemia duhet të ketë lindur në robëri, si shumë hebrenj të tjerë. Kjo është arsyeja se përse nuk i kritikova njerëzit që mbetën në Babiloni gjatë studimit të librit të Ezdrës. Edhe pse ishin jashtë vullnetit të Zotit, pati disa njerëz shumë të perëndishëm që nuk u kthyen në vend. Apostulli Pal tek Rom.14:4 thotë: *“Kush je ti që gjykon shërbyesin e tjetrit? A qëndron mbi këmbë ose rrëzohet ...”* Ne nuk kemi asnjë të drejtë që t’i gjykojmë këta njerëz. Ne duhet të jemi gjithmonë të kujdesshëm në gjykimin e besimtarëve të tjerë, kur nuk i njohim të gjitha rrethanat.

Ai *“u ul dhe qau”* – Nehemia kishte një punë shtetërore, por kjo nuk e pengoi të ulej poshtë dhe të qante. Vini re se ai *“mbajti zi për disa ditë me radhë, agjëroi dhe u lut”* Kjo ishte streha dhe pasuria e atyre njerëzve. Kështu veproi Ezdra dhe tani edhe Nehemia qan dhe lutet. Edhe një herë dua t’ju tërheq vëmendjen tuaj tek shprehja *“Perëndia i qiellit.”* Kjo shprehje shfaqet në librin e Ezdrës, Nehemias dhe Danielit. Ky është një emërtim i Zotit që është i vecantë për këta tre libra. Pas rënies dhe shkatërrimit të Jeruzalemit, Perëndia nuk mund të identifikohet më me tempullin dhe si Ai që banonte në mes të kerubinëve. Lavdia ishte larguar. Fjala *“Ichabod”* ishte shkruar mbi pllakat metalike të Izraelit. Zoti ishte kthyer në qiell. Për këtë arsye në librat e pas-robërisë Ai është *“Zoti i qiejve.”* Ai nuk u shfaq më deri në një kohë të caktuar në Betlehem, kur ëngjëlli tha: *“Lavdi Perëndisë në vendet më të larta”* (Luka 2:14). Krishti kishte ardhur në tokë i veshur me mish njerëzor. Një ditë Ai do të vijë sërish. Vetë Zoti Jezus Krisht tha: *“Dhe atëherë do të duket në qiell shenja e Birit të njeriut; dhe të gjitha kombet e dheut do të mbajnë zi dhe do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe.”* (Mt. 24:30). Nuk e di se çfarë është kjo shenjë, por dyshoj se do të jetë lavdia Shekinah e Zotit që do të kthehet.

Gjithsesi, në kohën e Nehemias Ai ishte Zoti i qiejve dhe Nehemia i drejtohet Atij në këtë mënyrë.

Kjo është një lutje e fuqishme dhe në kapitullin e 9-të do të bëhet edhe një lutje tjetër.

**“Dhe thashë: "Të lutem shumë, o Zot, Perëndia i qiellit, Perëndi i madh dhe i tmerrshëm, që i qëndron besnik besëlidhjes dhe ke mëshirë për ata që të duan dhe respektojnë urdhërimet e tua.”**  
[Neh. 1:5].

Le të ndalojmë këtu për një moment dhe të shohim fjalën “i tmerrshëm”. Me këtë fjalë është abuzuar shumë. Shpesh edhe është keqkuptuar. Në të vërtetë predikuesit nuk duhet të quhen reverend, sepse kjo fjalë do të thotë “i tmerrshëm” Ndoshta mund ta kem gabim, por disa prej nesh mund të quhen: “I tmerrshmi z. Filan.” Në të vërtetë fjala reverend është një fjalë që gjen zbatim vetëm për Zotin. Dikush ka thënë.

Më quaj shërbëtor, më quaj një mik  
Një vesh i dashur për të gjithë ata i dëgjoj  
Por mos ma copëto shpirtin tim  
Të lutem ndalo dhe mos më quaj reverend.

- Autori i panjohur

Reverend ishte një titull që u jepej shërbëtorëve në kohët e lashta dhe ata respektoheshin shumë në komunitet. Kjo nuk është e vërtetë për ditët e sotme. Në fakt, nuk është e vërtetë as edhe në kishë. Disa njerëz pretendojnë se kisha e tyre është ndryshe, por shumica e kishave janë një grup i vogël që përpiqen të kryqëzojnë predikuesin. Gjithsesi, në lashtësi, kur një predikues quhej reverend, tregonte respekt, edhe pse ishte një term i gabuar. Sot, mund ta dalloj fare mirë një person të pashpëtuar nga mënyra se si më drejtohet. Para disa viteve, kur shkova në një ndërmarrje pastrimi kimik, një djalë i ri që punonte atje më thërriste “reverend”. Nga momenti që hyra në atë ndërmarrje dhe derisa dola, ai person e përdori atë term të paktën 20 herë. Ai ishte i pashpëtuar dhe nuk i kushtoi shumë vëmendje asaj që i thashë kur i dëshmovava. Megjithatë i pëlqente të përdorte titullin “reverend” saherë që me drejtohej.

Perëndia është një Zot i tmerrshëm, Ai që shtyn terrorin. Por, Ai është edhe Perëndia “që i qëndron besnik besëlidhjes dhe ke mëshirë

*për ata që të duan dhe respektojnë urdhërimet e tua” Ai është një Zot gjykimi, por në të njëjtën kohë është edhe një Zot i mëshirshëm.*

**“qofshin veshët e tua të vëmëndshëm dhe sytë e tu të hapur për të dëgjuar lutjen e shërbëtorit tënd që tani ta drejton ty ditën dhe natën për bijtë e Izraelit, shërbëtorë të tu, duke rrëfyer mëkatet e bijve të Izraelit, që ne kemi kryer kundër teje. Po, unë dhe shtëpia e atit tim kemi mëkatuar.” [Neh. 1:6].**

Vini re fjalët e Nehemias në këtë lutje. A po thotë ai: “Unë vij për të rrëfyer mëkatet që ata kanë bërë?” Jo. Ai i rrëfen mëkatet “*që ne kemi kryer kundër teje: po unë dhe shtëpia e atit tim kemi mëkatuar.*” Ky njeri thotë me gojën plotë: “Unë jam një mëkatar. Shtëpia e atit tim ka mëkatuar. Kombi im ka mëkatuar.” Sa herë dëgjojmë rrëfime të tilla mëkati në kishat tona? Në lutjen e tij Nehemia bëri një rrëfim: dështimi i judenjve ishte për shkak të mëkatit. Nehemia tha: “Po unë dhe shtëpia e atit tim kemi mëkatuar.” Ky njeri nuk ishte një spektator farise që i jepte të drejtë vetes.

**“Jemi sjellë shumë keq me ty dhe nuk kemi respektuar urdhërimet, statutet dhe dekretet që ti i ke urdhëruar Moisiut, shërbëtorit tënd.” [Neh. 1:7].**

Ne mund të shohim nga ky varg që Nehemia i besonte Fjalës së Zotit. Ai pushonte në të. Ai e njihte Fjalën e Zotit. Ai ishte i shqetësuar për shkak se urdhërimet e Zotit ishin lënë pas dore.

**“Mbaje mend fjalën që i urdhërove Moisiut, shërbëtorit tënd, duke i thënë: "Në qoftë se do të mëkatoni, unë do t'ju shpërndaj midis popujve;” [Neh. 1:8].**

Nehemia nuk besonte vetëm në Fjalën e Zotit, por edhe në kthimin e judenjve në Jeruzalem. Sot, ka shumë predikues që nuk e besojnë këtë gjë. Kjo mund të jetë një nga arsyet pse Zoti përdor njerëzit laikë. E vërteta e Perëndisë nuk mund të depërtojë gjithmonë tek ne që jemi predikues, por Ai ndonjëherë mund të arrijë edhe tek një njeri laik.

**“por në rast se do të ktheheni tek unë dhe do të respektoni urdhërimet e mia, dhe do t’i zbatoni në praktikë, edhe sikur njerëzit tuaj të shpërndarë të jenë në kufijtë e qiellit, unë do t’i mbledh që andej dhe do t’i sjell përsëri në vendin që kam zgjedhur ku të banojë emri im”. [Neh. 1:9].**

Nehemia i tha Zotit: “Ti ke thënë se do të na shpërndaje nëse nuk do të të bindeshim dhe ne nuk të jemi bindur. Po kështu ke thënë se nëse do të ktheheshim tek Ti, edhe sikur të ishim në skajet më të largëta të tokës, Ti do të na sillje sërish në vend.” Nehemia e besonte se judenjtë do të ktheheshin në vend. Ai besonte në këtë gjë dhe kjo ishte arsyeja pse u lut në këtë mënyrë.

**“Tani këta janë shërbëtorët e tu dhe populli yt, që ti i ke çliruar me fuqinë tënde të madhe dhe me dorën tënde të fortë. O Zot, të lutem, qofshin veshët e tu të vëmëndshëm ndaj lutjes së shërbëtorit tënd dhe lutjes së shërbëtorëve të tu që ndjejnë kënaqësi kur kanë frikë prej emrit tënd; jepi, madje sot të lutem, një sukses të mirë shërbëtorit tënd, duke bërë që ai të gjejë zemërbutësi në sytë e këtij njeriu”. Unë atëherë isha kupëmbajtësi i mbretit.” [Neh. 1:10-11].**

Nehemia është i gatshëm dhe dëshiron të përdoret nga Perëndia. Por, ai nuk po vrapon para Zotit. Ai po lutet dhe po kërkon drejtim nga Perëndia. Ai thotë: “Nëse do të më përdorësh, unë e vë veten time në dispozicionin tënd.” Kur u lut për mbretin Nehemia e quajti atë “këtë njeri”. Ne do të shohim se ai do t’i kërkojë mbretit që të mund të kthehet në vend. Nehemia nuk donte të ecte para Zotit, kështu që shkon në fillim para Tij në lutje.

Këtu kemi përfunduar studimin e kapitullit të parë të librit të Nehemias dhe do të vazhdojmë me një hyrje të kapitullit të dytë për të cilin do të flasim më hollësisht në programin e herës së ardhshme.

## **Kapitulli 2**

Tema: Rikthimi i Nehemias në Jeruzalem

### **KËRKESA E NEHEMIAS PËR T’U KTHYER NË JERUZALEM**

Në këtë kapitull shohim se Nehemia kërkon leje nga mbreti dhe kthehet në Jeruzalem. Ai sheh rrënojat e qytetit dhe i inkurajon njerëzit të ndërtojnë muret.

**“Në muajin e Nisanit, vitin e njëzetë të mbretit Artakserks, sapo e sollën verën para tij, unë e mora verën dhe ia zgjata atij. Unë nuk kisha qenë i trishtuar kurrë në prani të tij.”**  
[Neh. 2:1].

Pikërisht në këtë pikë fillojnë “shtatëdhjetë javët” e Danielit: “në vitin e njëzetë të mbretit Artakserks.” Kjo është një datë e rëndësishme profecie.

Ky njeri Nehemia është një djalë i hirshëm, sic do ta shohim. Do të më pëlqente ta kisha njohur personalisht. Ai është ai lloj njeriu laik që ty do të pëlqente ta njihje. Ai kishte një pozitë politike si kupëmbajtësi i mbretit. Detyra e tij ishte të provonte cdo gjë para se t’ia conin mbretit. Për shembull, nëse mbretit i cohej një gotë me verë, Nehemia duhej ta provonte i pari. Nëse nuk do të kishte efekte sëmundje, atëherë mbreti do ta pinte verën. Puna e tij si kupëmbajtës ishte një punë e vështirë.

Puna e kupëmbajtësit kërkonte që Nehemia të ishte në prezencën e mbretit në më të shumtën e kohës. Në këtë mënyrë ai mund të bëhej mik i mbretit. Mendoj se sa herë që mbretit i duhej të merrte ndonjë vendim, do të pyeste kupëmbajtësin e tij: “Cfarë mendon në lidhje me këtë çështje?” Në këtë rast kupëmbajtësi ishte një lloj këshilltari, një anëtar i kabinetit të mbretit. Me shumë mundësi, Nehemia qëndroi në vendin e robërisë, për shkak të punës së tij, duke shpresuar se një ditë do të mund ta përdorte pozitën e tij për të ndihmuar njerëzit e tij. Ndoshta kjo ishte arsyeja pse i pyeti vëllezërit e tij se si ishin gjërat në Jeruzalem.

Nehemia po përgatitet t’i bëjë një kërkesë mbretit, por ai nuk ishte akoma gati. Atë ditë ai nuk ndihej mirë. Meqënëse kishte marrë lajmet e këqija për judenjtë në vend, po agjëronte, po mbante zi dhe po lutej. Mendoj se sytë e tij do të kenë qenë të kuq. Ai nuk kishte atë pamjen e zakonshme të lumtur. Kurrë më parë nuk kishte qenë kaq i trishtuar. Zakonisht, ai ishte një djalë i qeshur dhe gazmor. Mbreti e vuri re që Nehemia nuk ishte vetvetja.

Vazhdimin e historisë do ta ndjekim në programin tonë të herës së ardhshme. Deri atëherë mirudëgjofshim.

